

UDHËZIM

Nr. 7, datë 19.3.2012

PËR PËRDORIMIN E ADITIVIT USHQIMOR “E 960 STEVIOL GLYCOSIDE” NË PRODUKTET USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Përdorimi i aditivit ushqimor “E 960 Steviol Glykoside” në produktet ushqimore të prodhuara ose të importuara në Republikën e Shqipërisë, të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me publikimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI i Bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes

së konsumatorit

Genc Ruli